



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 1564/Prot.
8

Pogradec, më 26 . 04 . 2023

VENDIM

Nr. 44, datë 25.04 .2023

PËR MIRATIMIN E EMËRTIMIT TË RRUGËVE TË QYTETIT

Këshilli Bashkiak Pogradec në mbledhjen e datës 25.04 .2023, me propozim të kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1, nënpika 1.7 shkronja “b”, nenin 55 shkronja “11” të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeversijen vendore”, urdhërit Nr. 1411 datë 10.12.2008, për “Miratimin e modelit të adresës dhe rradhën e vendosjes së elementëve të saj” nenin 3 dhe 5 të ligjit nr.9270, datë 29.07.2004 “Për sistemin e adresave” (i ndryshuar), ligjit nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar).

VENDOSI

- 1.Miratimin e ndryshimit të emërtimit të rrugës nga “Rruga e Stadiumit” me emrin “**Kryepeshkop DAMIAN**” (AT.Dhimitër KOKONESHI) në Bashkinë Pogradec sipas planvendosjes të hartës bashkëngjitur.
2. Miratimin e ndryshimit të emërtimit të rrugës nga “Teuta” me emrin “**Luan STAROVA**” në Bashkinë Pogradec sipas planvendosjes të hartës bashkëngjitur.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (ndryshuar) dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut, Pogradec.

KRYETAR I KËSHILLIT

Sotirag MANCËRI

